



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 252, datë 28.12.2018

PËR
LICENCIMIN E ZJ. INA BALLIU PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BROKERIMI
NË SIGURIME, PËR KLASAT E JETËS DHE JO-JETËS NË EMËR DHE PËR
LLOGARI TË “BANKËS KOMBËTARE TREGTARE” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 209, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe Rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e zj. Ina Balliu, për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime, për klasat e Jetës dhe Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të “Bankës Kombëtare Tregtare” sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Klodion SHEHU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI